



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/81
Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për rregullimin e shërbimeve private të sigurisë në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /
Ministry Of Internal Affairs

**KONCEPT DOKUMENTI PËR RREGULLIMIN E SHËRBIMEVE
PRIVATE TË SIGURISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Prishtinë, 2016

EKIPI PËR ZHVILLIMIN E POLITIKAVE

Titulli i projektit të politikave:	
Koncept dokumenti për rregullimin e shërbimeve private të sigurisë në Republikën e Kosovës	
Produkti	Data e pritur e përfundimit
Koncept dokument	Shkurt, 2016
Ekipi	Emri dhe mbiemri
Udhëheqësi i ekipit	Agron Retkoceri
Zyrtare nga Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave	Marigona Ramaj
Ekspertë nga fusha përkatëse	Valbona Morina Fadil Marevci
Zyrtar ligjor	Mentor Hoxha
Zyrtar për buxhet	Vjollca Gashi
Zyrtarë të tjerë	Leonora Berkani - ICITAP Lulzim Fushtica – ICITAP
Zyrtar nga Policia e Kosovës	Haxhi Krasniqi

Afatet për përfundimin e dokumentit	Data
Data e fillimit	Prill 2015
Përfundimi i pjesës 1 dhe 2	Prill 2015
Përfundimi i pjesës 3, 4 dhe 5	Shtator 2015
Përfundimi i pjesës 6	Nëntor 2015
Konsultimi me akterët	Dhjetor 2015
Informimi i Sekretarit të Përgjithshëm dhe Ministrit	Dhjetor 2015
Përfundimi i pjesës 7	Dhjetor 2015
Përfundimi i tërë dokumentit	Dhjetor 2015
Konsultimi ndërministror	Dhjetor 2015
Ndryshimet dhe nënshkrimi i draftit përfundimtar nga Ministri	Janar 2016
Dorëzimi në Sekretariatit Koordinues të Qeverisë	Shkurt 2016
Ndryshimet dhe nënshkrimi i draftit përfundimtar nga Ministri	Shkurt 2016
Diskutimi në mbledhjen e Qeverisë	Shkurt 2016

Kapitulli I: Hyrje

Shërbimet private të sigurisë në Republikën e Kosovës, aktualisht ofrohen nga kompanitë private të sigurimit të licencuara dhe të autorizuar sipas Ligjit nr. 04/L-004 për shërbimet private të sigurisë. Ky ligj lejon ofrimin e shërbimeve private të sigurisë nga kompanitë private të sigurisë si: Shërbimet themelore të sigurimit dhe shërbimet e specializuara të sigurisë. Në kuadër të shërbimeve të specializuara të sigurisë private janë: Shërbimet e mbrojtjes së afërt, shërbimet e transportit të parave te gatshme dhe gjërave të tjera me vlerë, Shërbimet e vëzhgimit elektronik të pronës dhe shërbimet e sigurimit të tubimeve publike.

Shërbimet private të sigurisë në Kosovë, aktualisht janë të rregulluara me Ligjin nr. 04/L-004 për shërbimet private të sigurisë (në tekstin e mëtejme i referohemi si ligji aktual) dhe aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj.

Aktualisht, shërbimet private të sigurisë në Republikën e Kosovës ofrohen nga kompanitë private të sigurimit, të licencuara nga Ministria e Punëve të Brendshme bazuar në legjislacionin përkatës të lartcekur. Kompanitë private të sigurimit, këto shërbime i ofrojnë përmes punëtorëve të licencuar të sigurimit, te cilët duhet të jenë të uniformuar dhe të kenë pajisje përkatëse të sigurimit.

Bazuar ne Ligjin aktual, punëtorët e sigurimit janë të obliguar të trajnohen, certifikohen dhe të licencohen për të kryer shërbime përkatëse të sigurimit. Ligji aktual, punëtorëve të sigurimit u jep autorizime ligjore për kryerjen e shërbimeve private të sigurisë.

Shërbimet private të sigurisë të ofruara nga kompanitë private të sigurimit në Kosovë, kanë rezultuar si mbështetje shumë e madhe për institucionet e zbatimit të ligjit, për të ofruar siguri më të madhe për qytetarët e saj. Kjo vjen si rrjedhojë që punëtorët privatë të sigurimit fizik mund të gjenden në vende të ndryshme, në rrethana të ndryshme dhe të kontribuojnë në sigurinë e përgjithshme publike.

Korniza e tashme ligjore, e cila i rregullon aktivitetet në fushën e shërbimeve private të sigurisë, duhet të avancohet edhe më tej, në mënyrë që të fuqizohet funksionimi i përgjithshëm i kompanive private të sigurisë, si dhe të sigurohemi se kompetencat dhe detyrat e tyre do të kryhen në mënyrë sa më efektive dhe efektive.

Ligji aktual është i zbatueshëm, por ekzistojnë disa dispozita, të cilat kanë nevojë për riformulimin apo plotësim-ndryshimin, të cilat po e vështirësojnë ofrimin e duhur të shërbimeve private të sigurisë nga kompanitë private të sigurisë. Të gjitha mangësitë janë të specifikuar në pjesët përkatëse të koncept dokumentit. Si rrjedhojë e kësaj situatë, nevojitet plotësim-ndryshimi i këtij ligji, me qëllim të eliminimit të mangësive, paqartësive dhe ofrimit sa më efikas e efektiv të shërbimeve private të sigurisë nga kompanitë private të sigurimit.

Ky koncept dokument është pjesë e listës së koncept dokumenteve për vitin 2016, i aprovuar nga Zyra e Kryeministrit.

Kapitulli II: Përshkrimi dhe përkufizimi i çështjes

Shpjegim

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit aktual, përkatësisht gjatë zbatimit të tij në praktikë, janë hasur disa vështirësi si rezultat i mangësive dhe paqartësive të disa dispozitave. Për këtë arsye, është parë i domosdoshëm plotësim-ndryshimi i ligjit aktual.

Sipas Ligjit aktual, vetëm kompanitë private të licencuara të sigurimit, kanë të drejtë të ofrojnë shërbime private të sigurisë, por ligji në fjalë nuk ka ndonjë dispozitë, e cila në mënyrë decidive i jep të drejtë subjekteve të tjera (në këtë rast subjekteve afariste), që të licencohen për të kryer shërbime private të sigurisë vetëm për nevoja të tyre të brendshme, pa të drejtë të shitjes së shërbimit të sigurisë.

Me plotësim-ndryshimin e ligjit, është planifikuar që t'i jepet e drejta edhe subjekteve të tjera që të kryejnë shërbime private të sigurisë vetëm për nevoja të tyre të brendshme, pa të drejtë të shitjes së shërbimeve private të sigurisë. Kjo çështje është parë e domosdoshme që të rregullohet me ndryshim-plotësim të ligjit aktual, duke i marrë parasysh edhe kërkesat e shumta të subjekteve afariste, për t'u dhënë një e drejtë e këtillë. Këto kërkesa janë shfaqur sidomos gjatë zbatimit të ligjit përkatësisht inspektimeve të bëra nga inspektorët e kompanive private të sigurisë. Si rrjedhojë e kësaj çështjeje me plotësim-ndryshimin e ligjit, duhet të paraqiten edhe dispozitat, të cilat i përcaktojnë kushtet dhe kriteret për kryerjen e shërbimeve themelore të sigurimit për nevojat e tyre të brendshme, përfshirë këtu edhe dispozitat me të cilat duhet të përcaktohen se punëtorët e tyre të sigurimit duhet të trajnohen, certifikohen dhe licencohen sipas kriterëve të njëjta sikurse punëtorët e sigurimit të kompanive private të sigurimit. Me këtë plotësim ndryshim planifikohet që të luftohet informaliteti dhe marrëveshjet jo formale për punë. Kurse sa i përket numrit të punësuarve me marrëveshje jo formale në këtë fushëveprimtari nuk është bërë ndonjë studim por konsiderohet se ekziston një numër i madh të cilet janë të punësuar me marrëveshje jo formale të punës.

Në Ligjin aktual janë rregulluar vetëm pesë (5) lloje të shërbimeve private të sigurimit si: Shërbimet themelore të sigurimit, shërbimet e mbrojtjes së afërt, shërbimet e transportit të parave të gatshme e gjërave me vlerë, shërbimet e vëzhgimit elektronik të pronës dhe shërbimet e sigurimit të tubimeve publike. Mirëpo, në praktikë është parë e nevojshme të shtohen edhe dy forma (lloje) të shërbimit privat të sigurimit si: Shërbimet e sigurimit për infrastrukturë kritike dhe shërbimet për hoteleri, si dhe për diskoteka dhe klube të natës.

Me infrasktruktura kritike nënkuptojmë një aset, sistem apo pjese e saj e cila është thelbësore për mbarëvajtjen e funksioneve vitale të shoqërisë, shëndetit, sigurisë, mirëqenien ekonomike apo sociale të qytetareve, dhe dëmtimit apo shkatërrimi i të cilës mund të këtë pasoja të mëdha në shtetin, si rezultat i dështimit për t'i ruajtur ato funksione.

Roli i kompanive private të sigurimit kundrejt mbrojtjes dhe sigurisë së infrastrukturës kritike do të behet me ligji mbrojtje e infrastrukturës kritike.

Dispozitat e ligjit aktual, po ashtu rregullojnë licencimin e kompanive private të sigurimit për ofrimin e trajnimeve për punëtorët e sigurimit vetëm për katër (4) lloje të shërbimeve private të sigurisë. Mirëpo, kjo nuk e rregullon edhe të drejtën e kompanive apo institucioneve të tjera për t'u licencuar dhe për të ofruar trajnime për punëtorët e sigurimit edhe për shërbimet themelore të sigurisë.

Ofrimi i trajnimeve për punëtorët e sigurimit për shërbimet themelore të sigurisë, aktualisht ofrohet vetëm më udhëzim administrativ, por kjo çështje duhet të parashihet me ligj, sepse akti nënligjor nuk mund të parasheh më shumë të drejta se vet ligji. Si rrjedhojë e kësaj, është parë e nevojshme që t'i lejohet kompanive private të sigurimit dhe institucioneve të tjera që pas licencimit të tyre nga organi kompetent, të mund të ofrojnë trajnime për punëtorët e sigurimit për shërbimet themelore të sigurisë dhe llojeve të tjera të shërbimeve private të sigurisë, të cilat do të rregullohen me plotësim-ndryshimin e ligjit aktual.

Kompanitë private të sigurimit, të cilat ja ë të licencuara për ofrimin shërbimit të specializuar (shërbimet e mbrojtjes së afërt), kanë pengesa ligjore në ligjin aktual për ofrimin e këtij shërbimi, sepse: Personit që dëshiron të sigurohet nga kompania private e sigurimit, i cili ofron shërbime private të mbrojtjes së afërt i bëhet vlerësimi i rrezikut nga Divizioni për Vlerësimin e Rrezikshmërisë, i cili funksionon në kuadër të Policisë së Kosovës. Pas vlerësimit të rrezikut të personave, të cilët nuk kanë rrezikshmëri, atyre nuk u lejohet që t'u ofrohet shërbimi privat i mbrojtjes së afërt, gjë që e bënë të pamundshëm ofrimin e këtij shërbimi, prandaj me plotësim ndryshimin e ligjit aktual propozohet që kjo përgjegjësi e policisë për raste të tilla të hiqet.

Në ligjin aktual në disa dispozita, nuk janë përfshirë masat ndëshkuese si gjopa për kundërvajtje, në rast të moszbatimit të këtyre dispozitave. Për këtë arsye, ka vështirësi për zbatimin e disa dispozitave të ligjit.

Me plotësim-ndryshim të ligjit aktual lidhur me çështjet e lartshënuara, mund të pasojnë edhe plotësim-ndryshime të dispozitave të tjera të ligjit aktual, me qëllim të harmonizimit të tyre me plotësim-ndryshimet e reja.

Duke i marrë parasysh çështjet e lartshënuara, është vlerësuar si nevojë e domosdoshme plotësim-ndryshimi i ligjit ekzistues, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve private të sigurisë në Republikën e Kosovës.

Politika aktuale

Shërbimet e sigurisë private në Republikën e Kosovës, aktualisht rregullohen me Ligjin aktual dhe udhëzimet administrative të parapara me këtë ligj. Ministria e Punëve të Brendshme, ka përgjegjësinë kryesore për implementimin e këtij ligji.

Personat fizikë dhe juridikë, të cilët dëshirojnë të pajisen me licenca për ushtrimin dhe ofrimin e shërbimeve të sigurisë private, duhet të aplikojnë në MPB, më saktë në Departamentin për Siguri Publike (DSP), përkatësisht në Divizionin për Shërbimet Private të Sigurisë (DSHPS).

Divizioni për Shërbimet Private të Sigurisë, aktualisht lëshon dokumentet në vijim, për ofrimin e shërbimeve private të sigurisë për personat fizikë dhe juridikë:

- Certifikata të trajnimit për punëtorë për shërbim themelor dhe ata të specializuar;
- Licenca për kompani private të sigurimit për shërbimet përkatëse dhe punëtorë për shërbim themelor dhe të specializuara;
- Autorizime për nisjen fillestare të veprimtarisë për kompanitë private të sigurimit;
- Kartela identifikimi për punëtorët e sigurimit;
- Certifikata për qendrat e kontrollit;
- Certifikata për automjetet e transportit të parave të gatshme (TPG).

Bazuar në Ligjin aktual, detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Shërbimet Private të Sigurisë janë si vijon:

- kryen funksionet lidhur me licencimin dhe autorizimet e përcaktuara me këtë ligj;
- shërben si pikë kontakti për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet private të sigurisë;
- kryen monitorimin e aktiviteteve të kompanive private të sigurimit;
- bënë kryerjen e inspektimeve, të cilat konsiderohen të domosdoshme për monitorimin dhe rishikimin e aktiviteteve të kompanive private të sigurimit dhe punëtorëve të sigurimit që të sigurojnë;
- zbatimin e këtij ligji;
- vendosë dhe aprovon standardet profesionale të Kosovës për zbatim nga:
 - kompanitë private të sigurimit;
 - ata që i kërkojnë shërbimet e sigurimit dhe
 - punëtorët e sigurimit dhe të tjerët, që janë punësuar nga kompanitë private të sigurimit.
- bën rekomandime dhe propozime për ruajtjen dhe përmirësimin e standardeve profesionale të Kosovës;
- lëshon, plotëson, zgjatë, suspendon dhe revokon licencat;
- shqipton dënimet me gjobë në pajtim me këtë ligj;
- udhëheq procesin e regjistrimit dhe evidentimit për kompanitë private të sigurimit siç është përcaktuar me këtë ligj;
- respekton procedurat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në informatat publike në pajtim me ligjet e aplikueshme për mbrojtjen e të dhënave;
- lëshon kartelat zyrtare të identifikimit për punëtorët e sigurimit;
- organizon provimin për certifikim dhe ricertifikim të punëtorëve të sigurimit në pajtim me këtë ligj;
- siguron kryerjen e vlerësimit të kërcënimit për personat që sigurohen, siç është përcaktuar me këtë ligj.

Subjektet të cilat dëshirojnë të ofrojnë shërbime private të sigurisë, fillimisht duhet të aplikojnë për certifikatë të biznesit në MTI dhe të aplikojë në MPB, duke i plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e parapara më dispozitat ligjore.

Politika aktuale për licencimin e subjekteve afariste dhe personave fizikë për shërbimet private të sigurimit, është hartuar duke u bazuar në parimet dhe praktikat në rajon.

Që nga miratimi i Ligjit aktual dhe udhëzimet administrative që burojnë prej tij, të cilat e rregullojnë këtë fushë, përkatësisht gjatë periudhës kohore nga muaji majë i vitit 2012 deri , 22. Dhjetor 2015 për ofrimin e shërbimeve private të sigurisë për kompanitë private

të sigurimit dhe punëtorët e sigurimit, Ministria e Punëve të Brendshme ka lëshuar këto lloj licencash e certifikatash:

Çdo licencë e lëshuar nga organi kompetent është e vlefshme për përdhë tri (3) vjeçare nga dita e lëshimit, dhe mund tu zgjatet afati në bazë të kërkesës edhe pas rishikimit nga organi kompetent.

KOMPANIT E LICENCUARA PËR SHËRBIMET PRIVATE TË SIGURISË
2012- 22 dhjetor 2015

	LLOJET E LICENCAVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE PRIVATE TË SIGURIMIT	NR. I LICENCAVE 2012	NR. LICENCAVE 2013	NR. LICENCAVE JANAR - DHJETOR 2014	NR. I LICENCAVE JANAR - 22 DHJETOR 2015	TOTAL
1	LICENCAT PËR E SHËRBIMET THEMELOR TË SIGURIMIT	42	7	12	<u>41</u>	102
2	LICENCAT PËR SHËRBIMET TË MBROJTJES SË AFËRT	0	1	0	<u>1</u>	2
3	LICENCAT PËR SHËRBIMET TË TRANSPORTIT TË PARAVE TË GATSHM	3	4	0	<u>3</u>	10
4	LICENCAT PËR SHËRBIMET E VËZHGIMIT ELEKTRONIK TË PRONËS	4	9	5	<u>6</u>	24
5	LICENCAT PËR SHËRBIMET E SIGURIMIT TË TUBIMEVE PUBLIKE	4	6	3	<u>3</u>	16
6	LICENCAT PËR OFRIMIN E TRAJNIMEVE THEMELOR PROFESIONAL	4	2	1	<u>3</u>	10
7	LICENCIMI I INSTITUCIONEVE PËR TRAJNIME TË SPECIALIZUARA	3	0	0	<u>3</u>	6

CERTIFIKATAT PËR TRAJNIM THEMELOR PROFESIONAL DHE TË SPECILAIZUAR

	LLOJI I CERTIFIKATAVE PËR PUNËTOR TË SIGURIMIT THEMELOR DHE TË SPECIALIZUAR	NR. I TË CERTIFIKUARVE NË VITIN 2012	NR. I TË CERTIFIKUARVE NË	NR. I TË CERTIFIKUARVE NË	NR. I TË CERTIFIKUARVE JANAR	TOTAL

			VITIN 2013	VITIN 2014	- 22.DHJ ETOR 2015	
1	CERTIFIKIMI TRAJNIM THEMELOR PROFESIONAL	3096	2054	1036	<u>958</u>	7144
2	CERTIFIKIMI MENAXHER PËR SHËRBIMET THEMELORE TË SIGURIMIT	51	30	33	<u>19</u>	133
3	CERTIFIKIMI MENAXHER I SIGURIMIT PËR SHËRBIMET (TPG)	7	5	0	<u>1</u>	13
4	CERTIFIKIMI MENAXHER I SIGURIMIT PËR OPERATORT TË MBIKQYRJES ELEKTRONIKE	10	15	5	<u>7</u>	37
5	CERTIFIKIMI MENAXHER I SIGURIMIT PËR OPERATOR R TË MBROJTJES SË AFËRT	0	1	2	<u>1</u>	4
6	CERTIFIKIMI OPERATOR I MBIKQYRJES ELEKTRONIKE	60	100	49	<u>25</u>	234
7	CERTIFIKIMI OPERATOR I MBROJTJESË SË AFËRT	0	15	9	<u>0</u>	24
8	CERTIFIKIMI ROJE I TRANSPORTIT TË PARAVE TË GATSHME	62	12	99	<u>12</u>	185
9	CERTIFIKIMI MBAJTËS I QENIT	0	0	0	<u>0</u>	0
10	CERTIFIKIMI INSTRUKTOR PER TRAJNIME THEMELORE PROFESINALE	10	7	1	<u>4</u>	22
11	CERTIFIKIMI INSTRUKTOR PER OPERATOR TE MBROJTJES SE AFERT	16	0	0	<u>2</u>	18
12	CERTIFIKIMI INSTRUKTOR PER ROJET E TRANSPORTIT TE PARAVE TË GATSHME	16	1	0	<u>2</u>	19
13	CERTIFIKIMI INSTRUKTOR PER OPERATOR TE MBIKQYRJES ELEKTRONIKE	5	0	0	<u>2</u>	7

LICENCAT PËR PUNËTOR TË SIGURIMIT THEMELOR DHE TË SPECIALIZUAR

LLOJET E LICENCAVE PËR PUNËTOR TË SIGURIMIT THEMELOR DHE TË SPECIALIZUAR	NR. I TË LICEN CUARV E NË VITIN 2012	NR. I TË LICEN CUARV E NË VITIN 2013	NR. I TË LICEN CUARV E NË VITIN 2014	NR. I TË LICE NCU ARV E JANA	TOT AL
--	--	--	--	--	-----------

					R- 22 DHJE TOR 2015	
1	PUNËTOR TË SIGURIMIT THEMELOR	710	2965	1000	<u>958</u>	5633
2	MENAXHER PER SHËRBIMET THEMELORE TË SIGURIMIT	4	53	27	<u>20</u>	104
3	MENAXHER I SIGURIMIT PER SHËRBIMET (TPG)	0	6	1	<u>2</u>	9
4	MENAXHER I SIGURIMIT PER OPERATORT TË MBIQYRJES ELEKTRONIKE	5	9	10	<u>6</u>	30
5	MENAXHER I SIGURIMIT PER OPERATOR TË MBROJTJES SË AFËRT	0	1	1	<u>2</u>	4
6	OPERATOR I MBIQYRJES ELEKTRONIKE	8	89	31	<u>31</u>	159
7	OPERATOR I MBROJTJESË SË AFËRT	0	15	8	<u>0</u>	23
8	ROJE I TRANSPORTIT TË PARAVE TË GATSHME	0	61	26	<u>18</u>	105
9	MBAJTËS I QENIT	0	0	0	<u>0</u>	0
1 0	I INSTRUKTOR PER TRAJNIME THEMELORE PROFESINALE	5	11	2	<u>4</u>	22
1 1	INSTRUKTOR PER OPERATOR TE MBROJTJES SE AFERT	15	1	0	<u>5</u>	21
1 2	INSTRUKTOR PER ROJET E TRANSPORTIT TE PARAVE TË GATSHME	15	1	0	<u>5</u>	21
1 3	INSTRUKTOR PER OPERATOR TE MBIQYRJES ELEKTRONIKE	4	0	0	<u>5</u>	9

Janë lëshuar **5.354** licenca për punëtor të sigurimit dhe janë lëshuar **6.888** certifikata për punëtorë të sigurimit.

Shërbimet private të sigurimit, në vazhdimësi janë duke u profilizuar dhe specializuar. Kjo ndikon në rritjen e kërkesave për angazhimin e tyre në këtë fushë. Ky zhvillim krijon nevojën për ofrimin e infrastrukturës ligjore, e cila jo vetëm do të rregullojë në aspektin ligjor tregun e punës, por edhe do të jetë njëri nga faktorët që do të ndikojë në ngritjen e sigurisë në vend.

Ligji dhe aktet nënligjore

Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për hartimin e politikave nga fusha e sigurisë private, ndërsa Departamenti për Siguri Publike, përkatësisht Divizioni për Shërbimet Private të Sigurisë bën zbatimin e këtyre politikave.

Ligji aktual i rregullon çështjet që kanë të bëjnë në fushën e sigurisë private. Me këtë ligj vendosen rregullat për licencimin e kompanive private të sigurimit dhe punëtorëve të sigurimit, mënyrën e aplikimit për licencë, vazhdimin e licencës, refuzimi i kërkesës, mënyrën e ankimit dhe dispozitat ndëshkuese.

Aktet nënligjore për zbatimin e Ligji nr. 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë

1. Udhëzim Administrativ nr. 30/2011 –MPB për masat, autorizimet dhe detyrat e punëtorëve të sigurisë: Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është rregullimi dhe ndërmarrja e masave, si dhe detyrat dhe autorizimet e punëtorëve të sigurisë private. Me ndryshimin dhe plotësimin e autorizimeve të punëtorëve të sigurimit për shërbimet shtesë, të cilat janë parë si të nevojshme të shtohen në ligj, ky udhëzim administrativ duhet të ndryshohet.
2. Udhëzimi Administrativ nr. 31/2011 - MPB për caktimin e operatorit të Mbrojtjes së Afërt për Personin që sigurohet. Qëllimi: Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen procedurat që kryhen nga organi kompetent dhe kompania e licencuar private e sigurimit, lidhur me caktimin e operatorit të mbrojtjes së afërt për personin. Procedurat për lëshimin e autorizimit nga MPB, bazuar në vlerësimin e rrezikut, i cili aktualisht kryhet në Divizionin për Vlerësimin e Rrezikut të Policia së Kosovës duhet të ndryshohet.
3. Udhëzimi Administrativ nr. 11/2012 – MPB mbi masat, autorizimet dhe detyrat e kompanive private të sigurimit. Qëllimi: Me këtë udhëzim përcaktohen autorizimet dhe detyrat e kompanive private të sigurimit të licencuara për shërbimin themelor të sigurisë, mbrojtjes së afërt, sigurimit të tubimeve publike, transferimit të parave të gatshme dhe të mbikëqyrjes elektronike. Në këtë udhëzim duhet të shtohen shërbimet shtesë, të cilat janë paraparë si të nevojshme të futen në ligj dhe t'u lejohen autorizimet e shërbimeve të caktuara. Ky udhëzim duhet të plotësohet dhe ndryshohet.
4. Udhëzimi Administrative nr. 07/2012 – MPB për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave. Qëllimi: Me këtë udhëzim administrativ themelohet dhe përcaktohen procedurat e funksionimit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave.
5. Udhëzimi Administrativ nr. 10/2012 – MPB për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave nga organi kompetent. Qëllimi me këtë udhëzim administrativ përcakton mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe procedurat e mirëmbajtjes së kryer nga organi kompetent për shërbimet private të sigurisë.
6. Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2012 – MPB për trajnimin, certifikimin, ricertifikimin dhe licencimin e institucioneve trajnuese. Qëllimi: Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen procedurat për licencimin e kompanive dhe institucioneve trajnuese, organizimin e trajnimit themelor profesional dhe të specializuar, certifikimin dhe ricertifikimin e trajnimeve, si dhe organizimin e provimit profesional për sigurinë private. Institucionet trajnuese nuk janë të cekura në dispozitat e ligjit. Janë të nevojshme të ndryshohet plan-programi i trajnimeve për institucionet trajnuese që janë bazë e këtij udhëzimi dhe të shtohen plan-programet për shërbimet shtesë, të cilat do të vendosen në dispozitat e ligjit. Ricertifikimi i punëtorëve të specializuar për operator të mbrojtjes së afërt dhe rojet e transportit të parave të gatshme, që posedojnë armë zjarri gjatë detyrës zyrtare që është i paraparë në këtë udhëzim, nuk ka qene në harmoni me ligjin për armë, si dhe për kriteret për instruktor të shërbimeve private të sigurisë. Ky Udhëzim administrativ duhet të ndryshohet.

7. Udhëzimi Administrativ nr. 09/2012 – MPB për blerjen, ruajtjen dhe përdorimin e pajisjeve. Qëllimi me këtë Udhëzim Administrativ përcakton procedurat për blerjen, ruajtjen dhe përdorimin e pajisjeve nga kompanitë private të sigurisë.

8. Udhëzimi Administrativ nr. 08/2012 – MPB për procedurat e inspektimit. Qëllimi: me këtë Udhëzim Administrativ rregullohen mënyrat dhe procedurat e kryerjes së inspektimeve të kompanive private të sigurisë dhe punëtorëve të sigurimit nga inspektorët.

9. Udhëzimi Administrativ nr. 27/2011 – MPB për procedurat e Licencimit. Qëllimi: Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen procedurat e licencimit të kompanive private të sigurimit, punëtorëve të sigurimit, procedurat për dhënien dhe menaxhimin e kartelave të identifikimit, si dhe procedurat për pezullimin dhe heqjen e licencave.

10. Udhëzimi Administrativ nr. 29/2011 – MPB për qendra të kontrollit. Qëllimi: Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kriteret e kërkuara për certifikimin e një qendre të kontrollit.

11. Vendimi i datës 12.03.2012 Nr. 105/2012, bën caktimin e taksave administrative për shërbimet private të sigurisë.

Shpenzimet aktuale

<i>Kategoria e shpenzimeve</i>	<i>Shpenzimet faktike në vitin paraprak</i>	<i>Buxheti këtë vit</i>	<i>KASH për vitin e ardhshëm</i>
<i>Buxheti i Ministrisë</i>	<i>250.940.35</i>	<i>260.714</i>	<i>255.714</i>
<i>Buxhetet tjera</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>
<i>Financimi nga donatorët</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>
<i>Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Politikat dhe legjislacioni aktual janë duke u zbatuar, por gjatë zbatimit në praktikë janë paraqitur kërkesa dhe nevoja adekuate për shtimin e subjekteve afariste për të kryer shërbime private të sigurisë për nevojat e tyre të brendshme pa të drejtë të shitjes së këtyre shërbimeve, shtimin e llojeve të shërbimeve private të sigurisë, dhënien e të drejtës së kompanive private të sigurisë për kryerjen edhe të trajnimeve për shërbimet themelore të sigurimit dhe shtimin e masave ndëshkuese për disa dispozita të ligjit aktual. Trajnimi dhe certifikimi do të kryhet nga institucionet trajnuese të akredituara, ndërsa testimi do të kryhet nga organi mbikëqyrës i shërbimeve private të sigurisë konkretisht nga MPB. Për këto arsye është parë e domosdoshme që të bëhet plotësim-ndryshimi i ligjit aktual me të

vetmin qëllim, që të avancohen me tutje shërbimet private të sigurisë në Republikën e Kosovës.

Pra ndryshimi dhe plotësimi i ligjit aktual do të behet duke i vlerësuar në mënyrë të kujdesshme mangësitë, të cilat janë evidentuar gjatë zbatimit praktik të ligjit.

Përvoja nga shtetet e tjera:

Me marrjen e disa praktikave të reja, do të ketë ndikim të drejtpërdrejt në ngritjen e nivelit të shërbimeve private të sigurisë, që ka ndikim në sigurinë e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Legjislacioni i shtetit slloven parashihet si formë e shërbimit privat të sigurisë për nevojat e brendshme të subjekteve afariste si shërbim jo profitabil (për nevoja personale), që në rastin konkret do të ishte praktika më e mirë për luftimin e informalitetit.

Plotësim ndryshimi i ligjit aktual do të jetë në harmoni me nevojat, kërkesat dhe praktikatat vendeve të rajonit e të BE-së në këtë fushë.

Kapitulli III: Synimet dhe objektivat

Synimi

Synimi kryesor i këtij koncept-dokumenti, është forcimi dhe rregullimi i përgjegjësive të pronarëve të kompanive private të sigurisë dhe punëtorëve të sigurimit, si dhe rritja e besimit tek qytetarët në raport me shërbimet e ofruara nga kompanitë private të sigurisë.

Objektivat:

Objektivat e propozimit qëndrojnë në dy kategori kryesore dhe ato janë:

- 1). Rritja e përgjegjësisë dhe efektivitetit administrativ;
- 2). Rritja e kontrollit të MPB/DSP ndaj subjekteve përkatëse që ofrojnë shërbime private të sigurisë, për të siguruar zbatimin e plotë të masave dhe normave në fuqi.

Kapitulli IV: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni status-quo

MPB do të vazhdojë me zbatimin e legjislacionit aktual, por vazhdimi i **status-quo**, do të përcillet me probleme të paraqitura në këtë koncept dokument. p.sh. mos shtimi i formave të shërbimeve private të sigurisë, pamundësia e subjekteve të tjera për të kryer shërbime private të sigurisë për nevojat e tyre të brendshme pa të drejtë të shitjes së atyre shërbimeve, si dhe përcaktimi i masave sanksionuese të disa dispozitave të ligjit aktual. Me ekzistimin e këtyre problemeve, do të jetë vështirë të sigurohen shërbime sa me gjithëpërfshirëse në këtë fushë nga subjektet përkatëse.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese dhe ndryshimi i Ligjit aktual

Politika ekzistuese mund të ndryshohet duke:

- Shtuar numrin e formave të shërbimeve private të sigurimit;
- Plotësuar dhe ndryshuar disa dispozita të nevojshme të ligjit aktual sipas kërkesave të kohës;
- Rregullimi dhe shtimi i kritereve për institucione trajnuese për trajnime themelore profesionale dhe trajnime të specializuara me tutje për punëtorët e sigurimit të shërbimeve shtesë të parapara në ndryshim-plotësim të ligjit aktual;
- Përfshirja e masave adekuate ndëshkuese për disa dispozita të ligjit aktual, të cilat me herët nuk ishin të parapara.

Më saktësisht, plotësim-ndryshimi i Ligjit aktual përfshinë këto ndryshime:

- Paragrafi 1. Nenparagrafi 1.33 të nenit 2 të Ligjit aktual: “Menaxheri i sigurimit nënkupton punëtori i specializuar i sigurimit, i cili është përgjegjës për udhëheqjen e veprimtarisë së kompanisë private të sigurimit”. Do të ndryshohet në; menaxher i sigurimit - punëtor i specializuar i sigurimit, i cili është përgjegjës për udhëheqjen e shërbimit të caktuar të sigurimit.
- Nenparagrafi 1. 34. neni 2 të Ligjit aktual **Shërbimet e sigurimit**, janë shërbimet e kryera nga kompanitë private të sigurimit, të cilat ofrohen si shkëmbim për kompensim dhe në bazë të marrëveshjes kontraktuale në fushën e shërbimeve themelore të sigurimit, shërbimeve të mbrojtjes së afërt, shërbimeve të TPG-së, shërbimeve të vëzhgimit elektronik të pronës dhe shërbimeve të sigurimit të tubimeve publike. Në vazhdimësi të fjalisë se fundit të nenparagrafit 1. 34, do të shtohet teksti si në vijim: Shërbimet e sigurimit për hoteleri, diskoteka dhe klube të natës dhe shërbimet e sigurimit për objekte me rëndësi të veçantë.
- Nenparagrafi 1.37 i nenit 2 të Ligjit aktual: **Trajnimi i veçantë profesional** – trajnimi i specializuar, bazuar në standardet profesionale të Kosovës, i cili është detyruar për operuesit e mbrojtjes së afërt, rojet e TPG-së, operatori i mbikëqyrjes elektronike, mbajtësit e qenve dhe menaxherin e sigurimit/zyrtari në detyrë. Në vazhdimësi të fjalisë së fundit të këtij nenparagrafi, do të shtohet teksti si në vijim: Punëtor i sigurimit për hoteleri, diskoteka dhe klube të natës dhe punëtor i sigurimit për objekte me rëndësi të veçantë.
- Nenparagrafi 1.39 i nenit 2 të Ligjit aktual: “**Punëtori i specializuar i sigurimit** është personi i licencuar nga organi kompetent për aftësitë e specializuara në një veprimtari të veçantë të sigurisë private. Nenparagrafi 1.39 i nenit 2 të Ligjit Nr.04/L-004 për shërbimet private të sigurisë termi “veprimtari“ do të zëvendësohet me termin “shërbim”.
- Nenparagrafi 1.39 paragrafin 1 të nenit 2 të Ligjit aktual do të shtohet edhe një përkufizim i ri me nr. rendor 1.42. me tekstin si në vijim: **Shërbimet e sigurimit**

të brendshëm, që nënkuptojnë shërbimet themelore të sigurimit të ofruara nga subjekti afarist, pavarësisht formave të biznesit, i cili ofron sigurim fizik jofitimprurës personave dhe pronës në objektet dhe zonat e destinuar vetëm për nevojat e tij të brendshme.

- Në paragrafin 1 të nenit 2 të Ligjit aktual, do të shtohet edhe një përkufizim i ri me nr. rendor 1.43. me tekstin në vijim: Shërbimet e sigurimit për hoteleri, diskoteka dhe klube të natës nënkuptojnë shërbimet e sigurimit në objektet hoteliere, diskoteka dhe klube të natës, të cilat ofrohen përmes punëtorëve të sigurimit të licencuar sipas këtij ligji.
- Në paragrafin 1 të nenit 2 të Ligjit aktual, do të shtohet edhe një përkufizim i ri me nr. rendor 1.44. me tekstin në vijim: Shërbimet e sigurimit për objekte me rendësi të veçantë, nënkuptojnë shërbimet e sigurimit, të cilat ofrohen nga kompanitë private të sigurimit përmes punëtorëve të sigurimit të armatosur ose të paarmatosur, siç do të parashihet me ligjin për infrastrukturë kritike, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me këtë ligj dhe me legjislacionin përkatës.
- Në nenin 2 të Ligjit aktual të përkufizimet të shtohet edhe një paragraf i ri me tekstin në vijim: Plani i sigurisë do të thotë një dokument që përcakton metodën dhe qëllimin e ofrimit të sigurisë nga personeli i sigurimit. Masat e sigurisë pjesë përbërëse e planit të sigurisë, do të jetë vlerësim i nivelit të rrezikut, planit të sigurisë fizike dhe të programit të sigurisë për objekte që kërkojnë siguri të avancuar.
- Në nenin 3 të Ligjit aktual shtohet një paragraf i ri me tekstin si vijon: Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, shërbimet e sigurimit të brendshëm kryejnë nga subjektet e tjera përmes punëtorëve të licencuar sipas këtij ligji, pavarësisht nga forma e organizimit të biznesit të tyre.
- Në nenin 4 të ligjit aktual do të shtohet edhe një paragraf i ri, me tekstin si vijon: Shtetasit e huaj gëzojnë të drejtën të certifikohen dhe licencohen si punëtor të sigurimit, nëse i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë ligj, kriteret e tjera të përcaktuara me legjislacionin përkatës për të huajt dhe të ketë njohuri të njërës nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës;
- Në paragrafin 1 të nenit 5, të Ligjit aktual shtohen edhe dy (2) nënparagrafë të ri me tekstin si vijon: 1.6. Shërbimet e sigurimit për hoteleri, diskoteka dhe klube të natës dhe 1.7. Shërbimet e sigurimit për objekte me rendësi të veçantë.
- Në nënparagrafin 1.3. të nenit 7 të Ligjit aktual në fund të fjalisë pas fjalës “sigurimit”, do të shtohet teksti si vijon; “dhe subjektet tjera që kryejnë shërbimeve të sigurimit për nevojat e tyre të brendshme”.
- Në nënparagrafin 1.5.1. të neni 7 të Ligjit aktual në fund të fjalisë pas fjalës “sigurimi”, do të shtohet teksti si vijon; “dhe subjektet tjera që kryejnë shërbimet të sigurimit për nevojat e tyre të brendshme.

- Në nënparagrafin 1.5.3. të nenit 7 të Ligjit aktual në fund të fjalisë pas fjalës “sigurimit”, do të shtohet teksti si vijon: “dhe subjektet tjera që kryejnë shërbime të sigurimit për nevojat e tyre të brendshme”.
- Në nënparagrafin 1.9. të nenit 7 të Ligjit aktual pas fjalës “sigurimit”, do të shtohet teksti si vijon: “dhe subjekteve tjera që kryejnë shërbime të sigurimit për nevojat e tyre të brendshme”.
- Paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit aktual riformulohet si në vijim: Komisioni i Ankesave kryesohet nga një zyrtar i MPB-së, i cili nuk duhet të jetë i DSP-së.
- Titulli i neni 10 të Ligjit aktual “Licencimi i kompanisë private të sigurimit”, ndryshohet me tekstin si në vijim: Licencat për shërbimet private të sigurisë.
- Paragrafi 1 i nenit 10 të Ligjit aktual, do të riformulohet me tekstin si në vijim: Personi juridik, i cili është i regjistruar në regjistrin e bizneseve në Republikën e Kosovës ka të drejt të pajiset me licencë.
- Në paragrafin 1 të nenit 10 të Ligjit aktual, do të shtohen edhe dy (2) nënparagrafe me tekstin si vijon:
 - 1.6. shërbimet e sigurimit për hoteleri, diskoteka dhe klube të natës dhe
 - 1.7. shërbimet e sigurimit për objekte të rëndësisë së veçantë.
- Paragrafin 7 i nenit 10 të Ligjit aktual: Kompanitë private të sigurimit të licencuara në bazë të Ligjit për armë për aktivitetet në industrinë e armëve, ose që janë të lidhura me bizneset e tilla, nuk kanë të drejtë për të marrë licencë për të ofruar shërbime të sigurimit.
Ky paragraf riformulohet me tekstin si vijon: Kompanitë, të cilat merren me aktivitetet e industrisë së armëve të licencuara në bazë të Ligjit për Armë, nuk kanë të drejtë për të marrë licencë për ofrimin e shërbimeve private të sigurimit.
- Në paragrafin 2 të nenit 10 të Ligjit aktual, fjalia “kompania private e sigurimit”, ndryshohet dhe zëvendësohet me fjalinë “personi juridik”.
- Në nenin 12 të Ligjit aktual pas paragrafit 2 shtohet një paragraf i ri me nr. rendor 3, me tekstin si vijon:
 - 3. Shërbimet e sigurimit për hoteleri, diskoteka dhe klube të natës, përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 12, duhet t’i plotësojë edhe këto kushte:
 - 3.1. Të ketë menaxherin e sigurimit për hoteleri, diskoteka dhe klube të natës;
 - 3.2. Të ketë se paku 5 punëtorë të sigurimit për hoteleri, diskoteka dhe klube të natës .
- Në nenin 13 të Ligjit aktual të shtohet edhe një paragraf i ri me tekstin si vijon: Paragrafi 5 për t’u pajisur me licencë për ofrimin e shërbimeve të objekteve me rëndësi të veçantë, aplikuesi përveç kushteve të përcaktuara në nenin 12 paragrafin 1 të Ligjit aktual, duhet t’i plotësojë edhe këto kushte:

5.1. Të ketë se paku pesë (5) punëtorë të sigurimit për objekte me rëndësi të veçantë;

5.2. Të ketë dhomën e certifikuar të ruajtjes në pajtim me Ligjin për Armët;

5.3. Të ketë qendrën e certifikuar të kontrollit.

- Nenit 12 të Ligjit aktual i shtohet edhe një paragraf i ri me tekstin si vijon: Subjekti afarist, pavarësisht formave të biznesit, i cili është i regjistruar në regjistrin përkatës në Republikën e Kosovës, kanë të drejtë të aplikojnë vetëm për dy forma të biznesit për: Shërbimet themelore të sigurimit (shërbimet e sigurimit të brendshëm), sipas paragrafit 1 të nenit 12 dhe Shërbimet e sigurimit për hoteleri, diskoteka dhe klube të natës.
- Në nenin 15 të ligjit aktual, shtohet edhe një paragrafi i ri me tekstin si vijon: Përjashtim bëjnë veprat penale në komunikacionit të shkaktuara nga pakujdesia, e cila rezulton me lëndim trupor dhe dëmtim të pronës.
- Emërtimi i nenit 16 të ligjit aktual ndryshohet si vijon: Kushtet për licencim për punëtor të sigurimit.
- Paragrafi 1 i nenit 16 të Ligjit aktual ndryshohet si vijon:
Çdo aplikues individual që aplikon për licencë duhet t'i plotësojë këto kushte:
Nënparagrafi 1.1. i paragrafit 1 të nenit 16, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim; të ketë certifikatë shëndetësore valide për punësim.
Nënparagrafi 1.3. i paragrafit 1 të nenit 16 të Ligjit aktual të hiqet në tërësi.
Nënparagrafi 1.4. i paragrafit 1 të nenit 16, ndryshohet dhe riformulohet si vijon: Të posedojë certifikatën, e cila dëshmon se personi e ka përfunduar me sukses trajnimin themelor profesional.
- Në nenin 18 të Ligjit aktual, shtohen edhe dy paragrafë të ri me tekstin si vijon:
6. Përveç plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 16 të ligjit aktual, punëtorët e sigurimit për objekte të rëndësisë së veçantë, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:
6.1. Të ketë arritur moshën njëzetënjë (21) vjeçare;
6.2. T'i ketë tre (3) vjet përvojë pune në fushën e sigurisë;
6.3. Të ketë përfunduar shkollimin e mesëm;
6.4. Të ketë përfunduar me sukses trajnimin e specializuar për punëtorë të sigurimit për objekte të rëndësisë së veçantë dhe të posedojë certifikatën që e dëshmon këtë;
6.5. Të ketë kaluar me sukses provimin e specializuar nga organi kompetent;
6.6. T'i plotësojë kriteret relevante në pajtim me Ligjin për Armë;
7. Përveç plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 16 të Ligjit aktual, punëtorët e sigurimit për hoteleri, diskoteka dhe klube të natës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:
7.1. Të ketë përfunduar shkollimin e mesëm;
7.2. Të ketë përfunduar me sukses trajnimin e specializuar për punëtor të sigurimit për hoteleri, diskoteka dhe klube të natës dhe të posedojë certifikatën që e dëshmon këtë;
7.3. Të ketë kaluar me sukses provimin e specializuar nga organi kompetent;

- Në nenin 21 të Ligjit aktual, shtohen edhe tre paragrafë të ri me tekstin si vijon:
 3. Qendra e Kontrollit do të inspektohet në vazhdimësi nga organi kompetent, për rishikimin e kushteve minimale të përcaktuara.
 4. Qendra e Kontrollit nuk mund të shfrytëzohet nga dy kompani private të sigurimit.
 5. Certifikata e Qendrës së Kontrollit lëshohet për periudhën tre (3) vjeçare nga dita e lëshimit dhe mund t'i zgjatet afati në bazë të kërkesës pas rishikimit nga organi kompetent.
 6. Në rast ndryshimi të lokacionit të Qendrës së Kontrollit, kompania private e sigurimit obligohet që se paku një (1) muaji para zhvendosjes/ndrrimit të lokacionit se/te qendrës së kontrollit duhet ta njoftojë organin kompetent, me qellim që organi kompetent të ketë kohë të mjaftueshme për certifikimin e qendrës së re të kontrollit.
- Në paragrafin 1 të nenit 22 të Ligjit aktual, nevojitet autorizimi nga organi kompetent, para se kompania private e sigurimit, e cila është licencuar të ofrojë shërbime të mbrojtjes së afërt dhe t'i caktojë një operator të mbrojtjes së afërt personit që sigurohet.
- Paragrafi 1 i nenit 22 të Ligjit aktual, riformulohet si në vijim: Kompania private e sigurimit e licencuar të ofrojë shërbime të mbrojtjes së afërt para se të caktojë një ose më shumë operator të mbrojtjes së afërt për personin që sigurohet dhe obligohet të marrë autorizim nga organi kompetent.
- Paragrafi 2 i nenit 22 të Ligjit aktual: Organi kompetent këtë autorizim e jep apo e refuzon, mbështetur në vlerësimin e kërcënimit që kryhet nga organi kompetent përmes njësive të vlerësimit të kërcënimit të Policisë së Kosovës; Paragrafi 2 i nenit 22 të Ligjit aktual, ndryshohet dhe riformulohet si vijon: Organi kompetent këtë autorizim e jep apo e refuzon, bazuar në verifikimin e të kaluarës kriminale të lëshuar nga Policia e Kosovës dhe në bazë të arsyes.
- Paragrafi 1 i nenit 23 të Ligjit aktual, ndryshohet dhe riformulohet si vijon: Kompania private e sigurimit e cila ofron shërbime të caktuara ndaj klientëve sipas dispozitave të këtij ligji, është e obliguar të pajiset me autorizim për çdo marrëdhënie kontraktuale me klientin në vlerën 100 euro për periudhën kohore së paku një (1) muaj kalendarik.
- Në nenin 23 të Ligjit aktual, pas paragrafit 1 shtohet një paragraf i ri me tekstin si vijon: Kompania private e sigurimit, nuk obligohet të pajiset me autorizim sipas paragrafit 1 të këtij neni për marrëdhëniet kontraktuale me klientin në vlerën 100 euro, e cila dërgohet në mënyrë elektronike brenda 24 orëve në organin kompetent, pa e përjashtuar polisën e sigurimit, e cila ju garanton përgjegjësi profesionale dhe përgjegjësi ndaj palës së tretë.
- Në paragrafin 2 të nenit 23 të Ligjit aktual, shtohet edhe një nënparagraf i ri me tekstin si vijon: Plani i sigurisë.

- Në nenin 24 të shtohet një paragrafi i ri me tekstin si vijon: Polisa e sigurimit me të dhënat e domosdoshme duhet të përfshihen në kontratën, e cila lidhet midis kompanisë private të sigurimit dhe klientit të saj.
- Në nenin 36 të Ligjit aktual, shtohet edhe një paragraf i ri si në tekstin si vijon: Kompania private e sigurimit, është e obliguar që me shpenzimet e saj t'i pajisë me uniforma të punës punëtorët e tyre të sigurimit.
- Në paragrafin 5 dhe nënparagrafët 5.1 deri 5.15 të nenit 37 të Ligjit aktual fshihet dhe të njëjtat çështje rregullohen me akt nënligjor.
- Neni 37 i Ligjit aktual, riformulohet me tekstin si vijon: Kompania private e sigurimit mund të aplikojnë për marrjen e licencës për ofrimin e trajnimeve themelore profesionale.
 - 1.1. Për t'u pajisur me licencë për ofrimin e trajnimeve themelore profesionale, aplikuesi duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.2. Objekti duhet të ketë se paku një klasë me hapësirë prej minimum 40 m² dhe një sallë për trajnime praktike e taktike minimum 40 m².
 - 1.3. Paisjet për mbrojtje nga zjarri.
 - 1.4. Personelin duhet ta ketë si vijon: Një ligjërues për çështje ligjore, një instruktor të certifikuar për dhënien e ndihmës së parë, ose posedues i gradës mjekësore, pastaj duhet të ketë instruktor të certifikuar për parandalimin e zjarrit dhe instruktor të licencuar nga organi kompetent për trajnime themelore profesionale. Planprogrami i aprovuar nga organi kompetent për trajnime themelore profesionale.
- Në nenin 37 të ligjit aktual, shtohen edhe tre paragrafë të ri me tekstin si vijon: Trajnimi i pjesshëm ricertifikues për punëtor të sigurimit themelor bëhet çdo tre (3) vjet. Punëtori i sigurimit themelor, çdo 3 vjet duhet të përfundojë trajnimin rifreskues dhe ricertifikues, që të sigurohet efikasiteti dhe siguria, të cilat i pasqyrojnë ndryshimet në metoda dhe procedurat e përcaktuara në plan-program.
- Pas nenit 38 të Ligjit aktual, të shtohet edhe një nen i ri (38 A) me tekstin si vijon: Kushtet për licencimin e institucionit trajnues për ofrimin e trajnimeve themelore profesionale dhe trajnimeve të specializuara: T'i këtë themeluesit dhe pronarët në pajtim me legjislacionin në fuqi. Të jetë i regjistruar në regjistrin përkatës i paraparë me ligj. Të ketë personin përgjegjës, dëshminë e verifikimit të së kaluarës për personin juridik, personat përgjegjës dhe instruktorët e licencuar për çdo fushë përkatëse të shërbimeve private të sigurisë. Të ketë instruktor për trajnim praktik për përdorimin e prangave, shkopit dhe taktikat mbrojtëse.
- Do të shtohet një nen i ri (38 B) për kushtet, të cilat duhet t'i plotësojë objekti për ofrimin e trajnimeve të specializuara:
 - Objektet për trajnime të specializuara në fushën e sigurisë private, duhet t'i plotësojë kushtet si vijon:
 - leje ndërtimi të objektit, ose kontratë të nënshkruar me afat minimum 3 vjet;
 - 1.2. Hapësira të nevojshme për mbështetje administrative dhe logjistike; klasa me hapësirë prej së paku 50 m², të pajisura me pajisje të nevojshme për mbajtjen e ligjëratave. Klasat e përmendura më lartë, do të jenë adekuate për

numrin e kandidatëve, domethënë minimum prej 3m² për kandidat dhe 5 m² për trajnerin apo ligjëruesin, si dhe një sallë për trajnime praktike e taktike minimum 40 m².

- pajisje për mbrojtje nga zjarri.
 - Institucioni i licencuar, duhet të vendos për mënyrën e dukshme në pikën e pranimit të objektit; certifikatën e biznesit dhe licencën. Institucioni trajnues cakton zyrtarin në pikën e pranimit dhe është përgjegjës për evidentimin e hyrje-daljeve nga objekti i trajnimit. Bën mirëmbajtjen e librave të hyrje-daljes. Bën evidentimin e çdo kandidati për llojin e trajnimit dhe bën pajisjen me karta identifikimi për të trajnuarit dhe vizitorët.
- Duhet të shtohet një nen i ri (38 C) për institucionin për trajnime të specializuara në fushën private të sigurisë. Ka të drejtë të aplikojë për licencë që të ofrojë:
 - trajnime themelore profesionale;
 - trajnime për punëtor të sigurimit për hoteleri diskoteka dhe pabe të natës;
 - trajnime për punëtorë të sigurimit për objekteve me rëndësi të veçantë;
 - trajnime për operatorë të mbikëqyrjes elektronike;
 - trajnime për menaxherë të sigurimit;
 - trajnime për roje të transportit të parave të gatshme dhe gjërave me vlerë dhe
 - trajnim për operatorë të mbrojtjes së afërt.
 - Duhet të shtohet një nen i ri (38 D), në të cilin do të përcaktohen kriteret e trajnimit dhe licencimit për instruktorët e shërbimeve private të sigurisë.
 - Paragrafi 1 i nenit 39 të Ligjit aktual ndryshohet dhe riformulohet si vijon: Divizioni për shërbimet private të sigurisë mbikëqyrë kompanitë private të sigurimit, subjektet afariste dhe të gjithë ata që ushtrojnë veprimtarinë private të sigurimit përmes inspektimeve: të rregullta, të përsëritura dhe të jashtëzakonshme.
 - Nënparagrafi 4.1. i paragrafit 4 të nenit 39 të Ligjit aktual, ndryshohet dhe riformulohet si vijon: Shkeljet e këtij ligji nga punëtorët e sigurimit, kompanitë private të sigurimit, subjektet afariste dhe shërbimet e sigurimit të brendshëm.
 - Në nenin 39 të ligjit aktual, shtohet edhe një paragraf i ri me tekstin si vijon: Zyrtarët policorë kanë të drejtë të inspektojnë për licenca të shërbimeve private të sigurisë sipas nenit 10 dhe nenin 14 të Ligjit aktual dhe do të raportojnë në organin kompetent.
 - Paragrafi 5 i nenit 39 të Ligjit aktual ndryshohet dhe riformulohet si vijon: inspektorët mund të hyjnë në hapësira të punës në kompanitë private të sigurisë, dhe të subjekteve të tjera gjatë orarit të punës, aty ku ushtrohet veprimtaria private e sigurimit, pa paralajmërim paraprak, ekskluzivisht vetëm për qëllime të inspektimit.
 - Në nenin 45 të Ligjit aktual shtohen edhe disa masa ndëshkuese, të cilat nuk janë paraparë në ligjin aktual për kompanitë private të sigurimit, punëtorët e sigurimit dhe subjektet tjera, të cilat mund të kryejnë shërbime private të sigurimit të

brendshëm në mënyre të kundërligjshme. Masat ndëshkuese nuk janë paraparë në ligjin aktual, përkatësisht në dispozitat në vijim: neni 3, neni 10 paragrafi 5, neni 14 paragrafi 5, neni 27 paragrafi 6, neni 28 paragrafi 9, neni 33 paragrafi 3, ku nuk janë të përfshira si masa ndëshkuese (gjoba për kundërvajtje) në rast të moszbatimit të këtyre dispozitave.

Përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Ministria e Punëve të Brendshme.

Me ndryshim-plotësimin e ligjit aktual, do të evitohen çështjet të cilat janë evidentuar gjatë zbatimit në praktikë.

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Nëse politika ekzistuese qëndron e njëjtë, do të kemi një situatë ku do të vështirësohej zbatimi i Ligjit nr.04/L-004 për shërbimet private të sigurisë. Zbatimi ndryshe në praktikë i dispozitave ligjore do të përbënte shkelje ligjore.

Kapitulli V: Përmbledhja e opsioneve

Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit.	Mbetet situatë e njëjtë, dispozitat e ligjit mbeten të paqarta , si dhe mbetet trajtimi i çështjeve të njëjta në Ligjin nr.04/L-004 për shërbimet private të sigurisë.	Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit aktual me qëllim të evitimit të zbrazëtirave ligjore dhe duke përfshirë ofrimin shtesë të shërbimeve private të sigurimit, shtimin e subjekte të tjera (subjektet afariste), të cilave do t'u jepet e drejta për të kryer shërbime private te sigurisë për nevojat e tyre të brendshme të biznesit, pa të drejtë të ofrimit te tyre me kompensim. Përfshihet edhe shtimi i shërbimeve private për sigurimin e objekteve me rëndësi të veçantë, si dhe shërbimi i sigurimit për hoteleri diskoteka dhe klube të natës.	Nëse baza ligjore dhe politika ekzistuese qëndron, atëherë është e pamundur të vazhdohet me dispozita të ligjit aktual dhe shërbimet shtesë të sigurimit do të mbeten të pazbatuara.
Segmenti i popullsisë /sektori dhe rajoni i shënjestruar.	Qytetarët e Republikës së Kosovës, kompanitë private të sigurimit, subjektet afariste që	Qytetarët e Republikës së Kosovës, kompanitë private të sigurimit, subjektet afariste që kërkojnë te pajisen me	Qytetarët e Republikës së Kosovës, kompanitë private të

	kërkojnë të pajisen me licencë për shërbimet private të sigurisë.	licencë për shërbimet private të sigurisë.	sigurimit dhe subjektet afariste kërkojnë të pajisen me licencë për shërbimet private të sigurisë.
Karakteristikat e zbatimit. Kush është përgjegjës. Një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët.	Përgjegjës për zbatim është Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti për Siguri Publike.	Përgjegjës për zbatim është Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti për Siguri Publike.	Përgjegjës për zbatim është Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti për Siguri Publike.
Administrimi ose zbatimi i programit, ose i shërbimit.	Divizioni për Shërbimet Private të Sigurisë.	Divizioni për Shërbimet Private të Sigurisë.	Divizioni për Shërbimet Private të Sigurisë.
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese, si dhe zbatimi dhe dënimet.	Pa ndryshim.	Ndryshimi apo plotësimi i Ligjit nr.04/L-004 për shërbimet private të sigurisë, si dhe ndryshimi i akteve nënligjore.	Pa ndryshuar.
Stimulimet, ose jostimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat.	Buxheti i aprovuar.	Buxheti i aprovuar.	Buxheti i aprovuar.
Fushatat e edukimit dhe komunikimit.	Nuk ka.	Fushatë informuese.	Nuk ka.
Udhëzimet dhe kodet.	Nuk ka.	Nuk ka.	Nuk ka.
Afatet kohore kur hyn opsioni në fuqi.	I vazhdueshëm.		

Si opsion i rekomanduar është plotësim-ndryshimi i Ligjit aktual, apo nxjerrja e ligjit të ri për shërbimet private të sigurisë, i cili do të shfuqizonte Ligjin nr.04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë.

Kapitulli VI : Analiza e opsioneve

Përfitimet

1. Nuk ka përfitime. Subjektet afariste dhe kompanitë private të sigurimit, nuk do të mund të aplikojnë shërbime shtesë të sigurisë private.
2. Me këtë ndryshim të ligjit, do të ofrohen shërbime shtesë. Do t'u mundësohet subjekteve afariste të kenë shërbim të brendshëm vetëm për nevojat e tyre. Kompanive private të sigurimit do t'u jepet mundësia të kenë edhe dy shërbime private të sigurisë, ku do të profilizohen dhe do ofrojnë siguri përmes punëtorëve të specializuar të sigurimit dhe shërbimet e sigurimit për objekte me rëndësi të veçanta, pasi shteti nuk mund të angazhojë Policinë e Kosovës në të gjitha objektet e rëndësisë së veçantë, por mund t'ua besojë këtë detyrë kompanive private të sigurimit, si ngritja e nivelit të sigurisë private me ndikim në sigurinë e përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe do të shmangen paqartësitë e disa dispozitave të ligjit aktual.
3. Kompanitë private të sigurimit dhe punëtorët e sigurimit, do të licencohen, mirëpo nuk do të mund të aplikojnë për shërbime shtesë.

Pasojat negative

1. Opsioni për mos ndryshimin e ligjit aktual, nuk do të ketë përfitime, por vetëm pasoja negative për shkak të pamundësisë së zbatimit të ligjit në tërësi.
2. Opsioni 2 i propozuar është opsion ideal, sepse do të ketë ndikim pozitiv në definimin e detajeve të caktuara të kornizës ligjore lidhur me kompanitë private të sigurimit. Te shërbimet private të sigurisë, janë identifikuar të gjitha mangësitë e ligjit aktual. Besohet se me eliminimin e tyre në ligjin e ri, nuk do të ketë pasoja negative.
3. Vështirësi në zbatim dhe shkeljeve të dispozitave ligjore.

Efekti shpërndarës

Me ndryshimin e kësaj politike preken në mënyrë të barabarartë të gjitha kompanitë private të sigurimit në Republikën e Kosovës dhe afërsisht 5.354 punëtorët e sigurimit që janë të licencuar. Ndryshimi i politikës ndikon në mënyrë të barabarartë tek të gjitha rajonet në Republikën e Kosovës.

Kostoja

Ndryshimi i politikës, do të ketë ndikim në shtesë financiare. Një përmbledhje më e detajuar është bashkangjitur si Annex.

Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit financiar				
	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4
Opsioni 1				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve.		20,000	20,000	20,000
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave.		0.00	0.00	0.00
Financimi i pritur nga donatorët.		0.00	0.00	0.00
Opsioni 2				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve.		0.00	0.00	0.00
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave.		-	-	-
Financimi i pritur nga donatorët.		0.00	0.00	0.00
Opsioni 3				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve.		0.00	0.00	0.00
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave.		0.00	0.00	0.00
Financimi i pritur nga donatorët.		0.00	0.00	0.00

Kapitulli VII: Konsultimi

Ky koncept dokument, ka ardhur në bazë të nevojave të rregullimit të aspektit të shtimit të formave të shërbimeve private të sigurisë, përcaktimit të disa masave ndëshkuese, shtimit të subjekteve të tjera për të pasur të drejtë për të ofruar shërbimet private të sigurisë për nevojat e tyre, pa të drejtë të shitjes së këtyre shërbimeve. Gjatë procesit të konsultimit të brendshëm, kemi përfshirë ekspert të kësaj fushe brenda MPB-së, si ata të Departamentit Ligjor, Policisë së Kosovës, dhe ICTAP-it.

Procesi i konsultimit të jashtëm, do të bëhet sipas Rregullores nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë, që nënkupton se para procedimit për miratim në Qeveri, ky koncept do të dërgohet në konsultim, përfshirë këtu edhe institucionet tjera dhe grupet e interesit në këtë fushë.

Kapitulli VIII: Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1: Ky opsion për mos ndryshimin e ligjit aktual, nuk do të ketë përfitim, por vetëm pasoja negative për shkak të vështirësive në implementim. Sa i përket pasojave negative, janë vështirësitë në implementimin e ligjit për arsye të shumë zbrazëtirave ligjore dhe paqartësive të disa dispozitave në ligjin aktual.

Opsioni 2: Me këtë opsion eliminohet mundësia e interpretimeve të ndryshme dhe krijohet një qartësi ligjore. Gjithashtu, subjekteve afariste u krijohet mundësia e aplikimit të sigurimit të licencuar vetanak për sigurimin e pronave të biznesit të tyre. Tutje, zbatimi i këtij opsioni, nuk do të krijonte pasoja negative dhe të gjitha kompanitë private ndikohen në mënyrë të barabartë në nivel rajonal e shtetëror.

Opsioni 3: Me këtë opsion, nuk do të ketë përfitim, por vetëm pasoja negative, për shkak të vështirësive në implementim. Të gjitha kompanitë private ndikohen në mënyrë të barabartë qoftë në nivel rajonal apo shtetëror.

Kapitulli IX: (Rekomandimi)

Përmes këtij koncept dokumenti, rekomandohet plotësim-ndryshimi i Ligjit aktual apo nxjerrja e ligjit të ri, me të cilin do të rregullohen në mënyrë më konkrete shërbimet private të sigurisë, të cilat do të përshtaten me praktikat më të mira në rajon duke i harmonizuar, si dhe duke i shmangur paqartësitë e dispozitave të Ligjit aktual.

Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti për Siguri Publike, do të vazhdojë të jetë autoriteti, i cili shërben si pikë kontakti për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet private të sigurisë në vazhdimësi pa ndonjë kosto shtesë.

Duke i pasur parasysh të gjitha opsionet, si dhe pasojat negative dhe përfitimet e mundshme nga të gjitha opsionet, propozohet që të miratohet opsioni 2, si opsion më i favorshëm.

Kapitulli X: Komunikimi

Me rastin e miratimit të koncept dokumentit, Ministria e Punëve të Brendshme do t'i njoftojë palët e interesit, kompanitë private të sigurimit dhe subjektet afariste në Republikën e Kosovës. Në këtë kontekst, do të organizohet një takim në objektin e MPB-së. Mesazhi kryesor do të jetë njoftimi i mundësive të reja, që do t'i sjell ndryshimi i ligjit të ri për ofrimin e shërbimeve private të sigurisë.